

Sefedin Fetiu

## VEPRA E MIGJENIT NË KRITIKËN E PASLUFTËS

Pas çlirimit mund të pritej me plot arsye që vepra e Migjenit të ishte në qendër të vëmendjes së vëzhguesve kritikë. Kjo arsye qëndronte në faktin se në të trajtoheshin, përveç tjerash, momente dhe dukuri të gjendjes sociale dhe demaskohej me mjeshtri të rrallë artistike pozita e palakmueshme e shtresave të gjera të popullit. Në këtë aspekt vepra e Migjenit përputhej me disa intenca dhe aspirata të rendit shoqëror që konstituohej. Ç'është e vërteta, ai edhe i përkiste gjeneratës së inspiruar me idealin e barazisë sociale dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme kombëtare-shoqërore, sado që nën ndikimin e këtyre pikëpamjeve utilitare siç do të shohim, vepra e tij u ngushtua, u fut në mengene pragmatike, pësoi restriktion në aspektin semantik, sidomos konotativ, filozofik, struktural dhe përgjithësisht artistik. Negjithatë, një punë kuantitative, së cilës, natyrisht, nuk i mungoi as kualiteti, u zhvillua rreth afirmimit të krijimtarisë së poetit: filloi botimi dhe ribotimi i shkrimeve të tij, hulumtimi i atyre që ende nuk ishin gjetur e që dihej se ekzistonin, gjurmimi rreth biografisë dhe futja në programet e në tekstet shkollore, përpjekja që të përpilohet ndonjë monografi e shkurtër si dhe angazhimi e interesimi i kritikës që të ndriçohet ndonjë aspekt i prozës apo i poezisë së tij.

### 1. Prirja eseistike

I vetmi shkrim i kësaj kohe që ende nuk ishte përudhur prej kriterëve të caktuara ideologjike, por që kishte ruajtur një autonomi, një pavarësi vrojtimi përmes të cilit shqyrtonte veprën e Migjenit në mënyrë më të gjerë e më të çlirët, ishte ai i Arshi Pipës me titull *Përkujtimi i Migjenit*.<sup>1</sup> Ishte kjo në të vërtetë një bisedë, një konferencë e mbajtur, me ç'rast autori në fillim evokon disa kujtime për poetin, pasi që vetë e kishte njohur në Pukë. Si në shkrimin e tij të botuar para çlirimit në revistën „Kritika”, edhe në këtë vështrim autori procedon një ecuri eklektike të shqyrtimit

<sup>1</sup> Arshi Pipa, *Përkujtimi i Migjenit*, „Bota e re”, nr. 3, 4 dhe 5, Tiranë, 1945.

kritik. Nuk mund të thuhet se ky është një sinkronizim i metodave të ndryshme, por më tepër është një përzierje e tyre, aplikim i tyre varësisht nga momenti dhe materia që trajton. Kështu, në të hasim elemente të hulumtimit deskriptiv të biografisë, asosh të metodës empirike, impresioniste, konstatime të bazuara në vërtetimin e drejtëpërdrejtë intuicionist, parafrazime dhe aty-këtu ndonjë analizë. Ky shkrim nuk dallohet aq shumë prej atij të mëparshmit, bile mund të thuhet se disa çështje i përsërit, siç është rasti me poezinë *Kanga e Perndimit* ose krahasimi me Aleshën, por, megjithatë, sjell edhe ndonjë element të ri. Një element i tillë që për herë të parë theksohet rreth veprës së Migjenit është pohimi se poeti ka njonur letërsinë jugosllave.

Gjatë shqyrtimit të veprës ky autor nuk përqëndrohet në një aspekt, por pa e kryer plotësisht njërin kalon në tjetrin. Ai bën përfoljen e prozave apo të poezive e pastaj kalon në çështjen e teknikës së vargut për të dalë në formulimin e konvencës, të kahjes, të orientimit të krijimtarisë së Migjenit, të cilën e ndan në dy drejtime: në lirikë subjektive dhe në rrymë sociologjike, me ç'rast ai ngatërron nocionin *sociologjike* për *sociale*. Më tutje autori e karakterizon ndonjë poezi si çelës të të tjerave. Por, ai nuk është konsekuent, sepse herën tjetër për çelës të poezisë së Migjenit ai merr sëmundjen e tij, ku e kanë burimin edhe melankolia edhe pesimizmi. Feja, nga ana tjetër, është prapë problemi crucial i poezisë së Migjenit. Pra, na dalin disa çështje thelbësore njësoj të rëndësishme, të cilat autori nuk ka arritur t'i sistematizojë, meqë, si duket, botimi i këtij shkrimi është bazuar në bisedën spontane që ka zhvilluar, pa intervenuar në mbarështrimin e stilit e të digresioneve të ndryshme. Kështu, pasi ngre disa çështje dhe pasi merr në shqyrtim ndonjërin prej krijimeve, autori prapë u kthehet karakteristikave të përgjithshme të veprës, duke theksuar se Migjeni e nis për herë të parë poezinë shoqërore, se sjell një frymë të re dhe se e pajis artin tonë, si Bodleri, me një dridhje të paparë. Pastaj prapë kalon në çështjen që e kishte theksuar në shkrimin e mëparshëm të „Kritika” e që, vërehet qartë, i kishte lënë përshtypje të thellë: përmend uzurpimin e të drejtës së autorit që ta shohë frytin e vet, vështirësitë rreth botimit, rrëmbimin e librit nga depoja, kopjimin dhe daktilografimin e tij. Në vijim, autori hidhet në karakterizime dhe thotë se në poezinë *Shpirt'i ri* poeti paraqet vetëveten, se ai nuk ishte një viga si Fishta që këndonte lahutën e trimërisë, por si shpirt delikat e i dhimbshëm, këndonte lahutën e mjerimit. Nga fundi sugjeron që sado të ketë simpati ndaj këtij poeti, kritika e vërtetë, objektive nuk mund të kalojë në beshtje të metat e veprës së tij.<sup>2</sup>

Vërehet qartë se kompozicioni i këtij shkrimi kritik është i parregullt, shkapërderdhje e çështjeve andej-këndej dhe thujse i përngjan një galimatias. Megjithatë, po ta marrim shkapërderdhjen

<sup>2</sup> Po aty.

e kompozicionit të një shqyrtimi kritik si një veçori të eseut,<sup>3</sup> do të mund të konstatojmë se te ky shkrim hetojmë disa prirje eseistike përmes të cilave bëhen vrojtime interesante dhe jepen gjykime të çmueshme.

## 2. Fillet e kritikës utilitare

Shkrimi i parë me tendenca utilitare e me elemente të kritikës ideologjike pas lufte është ai i Dhimitër Shuteriqit botuar në *Literatura jonë*.<sup>4</sup> Autori e vë në rend të parë rëndësinë ideore e jo atë artistike, siç kishte bërë para dhjetë viteve në revistën „Përpyjekja shqiptare”, ku shkruante për artin e Migjenit. Që në fillim vërejmë përpjekjen që poeti dhe orientimi i krijimtarisë së tij të vihen gjithësesi në lidhje me lëvizjen komuniste të kohës. Në këtë shkrim, autori vë në pah ndikimet që kishte pësuar Migjeni nga letërsia realiste ruse dhe veçmas, nga ajo sovjetike e realizmit socialist të Gorkit e të Majakovskit. Shuteriqi vë në spikamë edhe disa rrethana kombëtare dhe evropiane që ndikuan në orientimin ideor të shkrimeve të Migjenit. Kështu, ai cek se si në Korçë në vitet 1935 qarkullon libri i Luj Aragonit me titull *Për një realizëm socialist*; se „Bota e re” e shpalli këtë drejtim si të vetmin që mund ta ndjekë rinia; ndërkohë — duke vënë në tëh të kritikës — thekson artikujt e „Illyrisë” profashiste, të Branko Merxhanit, të Anton Logorecit, të Ismet Totos, të E. Koliqit, pastaj hymnet e Ali Asllanit për *Mbretin tonë*, tragjeditë klasike të Et’hem Haxhiademit etj. Që ta përforcojë sa më tepër kriterin ideologjik në shqyrtimin e veprës së Migjenit, Shuteriqi shkruan se ndikimet nga Bodleri, Niçe, Dostojevski, Leopardi etj., që mund të vërehen aty-këtu, janë pasojë e njohjes së pamjaftueshme të poetit me teorinë marksiste. Siç mund të vërehet, ky është një vështrim i objektit estetik kryekëput në prizmin ideologjik. Është kjo një ndër predikimet e para didaktike që përmes koncepteve utilitare ai kanalizon gjykimin vlerësues, sugjeron mënyrën e vërtimit e të analizës dhe programon qëndrimin jo vetëm ndaj Migjenit po edhe ndaj letërsisë në përgjithësi.

Përveç pjesës së përgjithshme në të cilën shkruan për kushtet dhe rrethanat historike shoqërore e politike të kohës, edhe kur kalon në analizën e krijimeve veç e veç, siç janë *Legjenda e misrit*, *Bukuria që vret*, *Recital'i malsorit* etj., Shuteriqi përqëndrohet në aspektin ideo-tematik duke lënë anash veçoritë e brendshme estetikë. Kështu ai, psh., shkrimet e Migjenit i karakterizon me nocione tipologjike jashtëletrare: realizëm militant, revolucionar etj. Me këtë terminologji, me këto lloj formulime bëhet përpjekje që të theksohet funksioni i jashtëm i krijimtarisë së Migjenit. Autori pikas vetëm ato momente të paraqitjes artistike që mund të jenë në për-

<sup>3</sup> Vlatko Pavletić, *Analiza bez koje se ne može*, „Zora”, Zagreb, 1961, fq. 13.

<sup>4</sup> Dhimitër S. Shuteriqi, *Migjeni*, „Literatura jonë”, nr. 8, Tiranë, 1948.

puthje me kahet e zhvillimit të shoqërisë, me synimet e saj. Të *birtë e shekullit të ri*, për shembull, janë punëtorët, komunistët; *Shkëndija* paraqet shokët revolucionarë, kurse *Dielli alegorik* — Bashkimin Sovjetik. Përmes një veprimi impresionist dhe të përfoljes së shprehjeve të poetit, autori bën një interpretim të njëanshëm, tepër të fikësuar, ndërsa gjuhën e pasur konotative poetike e shndërron në fraza denotative propagandistike e ideologjike që kanë vetëm një kuptim të caktuar.

Duke u mbështetur në postulatet e një kritike tradicionale pozitiviste me theks ideologjik, pasi e shqyrton përmbajtjen revolucionare të disa krijimeve të Migjenit, Shuteriqi i kthehet formës, për të cilën gjithashtu thotë se ishte shprehje e revoltës kundër paragjykimave, konformizmave dhe strofave të stërmatura të Fishtes, E. Koliqit, V. Prenushit etj. Autori i këtij shkrimi i mohon gjurmët e ndikimit nga letërsia jonë. Migjeni, sipas tij, nuk e njihte as Naimin e as Çajupin. Por, është interesant se Shuteriqi e pranon ndikimin që mund të ketë pasur Migjeni nga letërsia evropiane, nga simbolistët frëngë, italianë e jugosllavë, si dhe nga futuristët e surealistët.<sup>5</sup> Një pohim i tillë mund të vinte nga një njohës i mirë i veprës së Migjenit dhe i drejtimeve të ndryshme letrare në Evropë. Përmes një analize të përqëndruar në strukturën e krijimeve Shuteriqi do t'i evidentonte dhe do t'i gjente këto përkime. Por, koha kur u shkrua ky vështrim kërkonte një analizë dhe vlerësim në një aspekt tjetër. Shuteriqi arriti të bënte disa vrojtime interesante sa i përket versifikacionit të *Vargjeve të lira*, për të cilat thotë se nuk jatë të tilla, sepse në to ka rregulla, ritëm, rimë etj. Shuteriqi pohon se Migjeni nuk e ka njohur sa duhet teknikën e prozodisë shqiptare.

Në fund të këtij vështrimi, autori dallon disa prej prozave të Migjenit të cilat i konsideron si proza poetike të ngritura në një lloj letrar më të denjë seç ishin në kohën kur i lëvronte Faik Konica. Në mënyrë që të mbushet korniza e qasjes pozitiviste, ky shkrim rrumbullaksohet me një shqyrtim të shkurtër për gjuhën e veprës së Migjenit, e cila, sipas Shuteriqit, dallohet nga shkrimtarët e tjerë të Shkodrës dhe ka ndonjë dobësi.

### 3. Tematizmi i kritikës rreth veprës së Migjenit

Po ta parafrazonim kushtimisht në çështjen tonë thënien e Dostojevskit, do të mund të konstatojmë se ashtu si ajo gjeneratë shkrimtarësh që ka dalë nga *Palltoja* e Gogolit, edhe shkrimet kritike të kësaj faze rreth veprës së Migjenit, në pjesën më të madhe kanë dalë nga vështrimi i Shuteriqit në „Literatura jonë”. Sa i përket kriterëve ideore, orientimit dhe qasjes kritike, ato praktikisht gjenden në atë hulli, sado që brenda tyre mund të ketë analiza interesante të krijimeve, të strukturës kuptimore apo ndërtimore siç është rasti me vështrimin e mrekullueshëm të Koço Bihikut për prozën e

<sup>5</sup> Po aty.

Migjenit, pastaj shkrimet e Razi Brahimit, të Vehbi Balës, të Mark Gurakuqit, të Rexhep Hoxhës, të Adriatik Kallullit etj.

Në përgjithësi shkrimet e kësaj faze i karakterizon një procedim i kritikës tradicionale pozitiviste me elemente të asaj analitike e me theks të veçantë në komponenten ideologjike.

Krahas përpjekjeve që të gjurmohen, të grumbullohen e të botohen sa më komplet veprat e Migjenit, në këtë kohë bëhen orvatje drejt orientimit të të dhënave biografike dhe dalngadalë kalohet në shqyrtimin e krijimtarisë. Hulumtuesit, veçmas vihen në kërkim të prozave të Migjenit. Kështu, pas punës që kishte bërë Shuteriqi me gjetjen dhe tubimin e gjashtëmbëdhjetë prozave, nën redaktimin e Gjovalin Lukës më 1954, do të thotë në krye të dhjetë viteve të botimit të parë të *Vargjeve të lira*, publikohen *Veprat e Migjenit*, ku përmbledhet proza dhe poezia e tij. Lidhur me këtë botim kemi një recension të redaksisë së revistës „Nëntori”,<sup>6</sup> ku, përveç informimit bëhet edhe një vështrim rreth cikleve dhe disa krijimeve, me ç’rast vihen në pah kryesisht vlerat ideore të tyre.

Autorë të ndryshëm të kësaj kohe, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë, ndriçojnë momente nga jeta e shkrimtarit dhe shqyrtojnë në ndonjë aspekt të krijimtarisë së tij. Këto shkrime i karakterizon qasja filologjike-pozitiviste dhe analiza e tematikës së krijimeve apo përfolja e thjeshtë e përmbajtjes së tyre. Kështu veprojnë, psh., Vehbi Bala, Skënder Luarasi, Ramiz Kelemendi etj.<sup>7</sup> Në shkrimet e tyre këta autorë sjellin hollësi të reja biografike e bibliografike; flasin për kohën, rrethanat, kushtet në të cilat ka vepruar shkrimtari; japin aso shënimesh nga jeta e shkrimtarit që shpesh nuk janë të rëndësishme për krijimtarinë e tij; pastaj kalojnë në trajtimin e tematikës ose të motivikës së krijimeve, duke i hedhur një vështrim vargut, ritmit apo rimës dhe në fund gjuhës. Si kurorë e gjithë kësaj është gjykimi dhe vlerësimi i pikëpamjeve, i ideve dhe i botëkuptimeve që burojnë nga vepra e tij. Një gërshe-tim i këtillë i metodës biografike me kritikën deskriptive e aty-këtu analitike, mund të arsyetohet meqë bëheshin hapat e parë për njohjen e plotë të veprës së Migjenit. Por, shkrimi dhe orientimi i të gjitha komponenteve e aspekteve në rezultatën ideologjike ishte cungim dhe varfërim i veprës.

Të njëjtën gjë e bëri edhe Shuteriqi në tekstin e *Historisë së letërsisë* për shkollat e mesme në vitin 1958. Sado që i shkruar me mjeshtri, i kompletuar me të dhëna të reja, me vrojtime interesante të analizës kuptimore të prozës e të poezisë, veprës në fjalë ia ngushton dhe ia zë frymën kritika ideologjike.

Edhe atëherë kur ndonjëri prej këtyre autorëve, siç është p.sh. Ramiz Kelmendi, mundohet ta shqyrtojë materien thjesht në aspektin tematik, vetëvetiu bie në ngushticë ideologjike, sepse traj-

<sup>6</sup> Nëntori, nr. 5, Tiranë, 1954.

<sup>7</sup> Shih: Vehbi Bala, *Milosh Gjergj Nikolla (Migjeni) (1911—1938)*, Buletini i Institutit të Shkencave, Shkencat shoqërore, Tiranë, nr. 1, 1954; Skënder Luarasi, *Parathënie në librin Migjeni: Vepra*, Tiranë, 1957; Ramiz Kelmendi, *Proza e Migjenit*, „Jeta e re”, nr. 5, Prishtinë, 1955,

ton vetëm anën e jashtme të problemit, planin mimetik, komponenten gnoseologjike e jo atë artistike, poetike që do të kishte pa dyshim reperkusione më të gjera e më të thella kompozicionale etike, filozofike, psikologjike, strukturale etj.

Autorët e kësaj faze të shkrimeve kritike rreth veprës së Migjenit kanë interesime të shumëllojshme. Disa prej tyre si Teufik Gjyli, Mehmet Dermeni, Stefi Andrea etj., i preokupon jeta e Migjenit si mësues, vështirësitë rreth botimit të *Vargjeve të lira*, pikëpamjet dhe idetë e tij ndaj artit, jetës e shoqërisë. Si bashkohës, kolegë dhe shokë të shkrimtarit, ata në shkrimet e tyre evokojnë disa momente dhe kujtime interesante.<sup>8</sup> Veçmas është me interes shënimi i Stefi Andreas për peripecitë dhe kokëçarjet e poetit me rastin e botimit të ndaluar të poezive më 1936. Mirëpo, të vetëdijsëm se në fushën e letërsisë dominon maniheizmi ideologjik, kriteret politike e të tjera jashtëletrare, këta autorë, disi tepër i theksojnë dhe i sforcojnë elementet që e favorizojnë Migjenin në një situatë të tillë. Ç'është e vërteta, vepra e Migjenit nuk kishte nevojë për kurrfarë mistifikimesh, sepse vlera e saj ideologjike i imponohej vetëvetiu publikut lexues me mënyrën e trajtimit e të formësimit. Kjo vlerë imanente dominonte në horizontin e pritjes dhe nuk varej nga ndihma e jashtme, nga parulla, propaganda dhe gjykimet deklarative.<sup>9</sup>

Interesimi dhe entuziazmi për Migjenin në këtë kohë është aq i madh, saqë nga dëshira që të thuhet diçka sa më shpejt për këtë poet në afirmim e sipër, ndonjë autor nuk ngurron që të huzojë elemente nga ndonjë shkrim i mëparshëm dhe kështu, pa u lodhur fare, të sajojë plagiatin.<sup>10</sup> Natyrisht, lidhur me këtë plagiat, nuk mungoi reagimi dhe polemika.<sup>11</sup> Ndonjë entuziasti tjetër të kësaj kohe i shkon për dore që të bjerë në kontakt me të dhënat që flasin për jetën dhe preokupimet e Migjenit derisa ishte nxënës në seminarin e Manastirit.<sup>12</sup>

Janë disa shkrime të kësaj periudhe që imponohen me gjerësinë dhe thellësinë e kapjes së problematikës, sado që jo edhe me

<sup>8</sup> Shih: Mehmet Dermeni, *Me Migjenin në Pukë*, Nëndori, nr. 5, 1954; Stefi Andrea, *Rreth historisë së botimit të vëllimit „Vargjet e lira“*, Nëndori, nr. 11, Tiranë, 1955; Teufik Gjyli, *Disa shënime të jetës së Migjenit në vitet 1934—1937*, Nëndori, nr. 11, Tiranë, 1955.

<sup>9</sup> Është për t'u habitur se si këto lloj mistifikimesh — përkundrejt vlerësimeve të drejta, studimeve objektive e nganjëherë mbiçmimit të vlerave — nuk iu ndan Migjenit deri në ditët tona. Mendoj se është koha që njëherë e përgjithmonë të ndalin sogjimin e tyre këta kujdestarë ideologjikë, botëkuptimorë e vulgarizues kritikë.

<sup>10</sup> Shih: Hasan Vokshi, *Migjeni, jeta dhe vepra*, „Jeta e re“, nr. 2, Prishtinë, 1949. Pjesa më e madhe e këtij shkrimi është marrë nga vështrimi i Qemal Draçinit në revistën „Fryma“, 3—4, Tiranë, 1944.

<sup>11</sup> Shih artikullin e Hasan Kaleshit në „Jeta e re“, nr. 5, Prishtinë, 1951.

<sup>12</sup> Petro Janura, *Migjeni në Manastir*, „Flaka e vëllaznimit“, Shkup, 1956, 6. XI fq. 5 dhe: *Edhe diçka rreth Migjenit si nxënës në Manastir gjatë vjetit 1926—1927 (nga jeta e poetit të njoftun)*, „Flaka e vëllaznimit“, Shkup, 1 tetor 1957, fq. 5—6.

mënyrën e zgjidhjes e të zbërthimit të saj. Të këtillë janë, p.sh. shkrimet e Razi Brahimit, Mark Gurakuqit, Koço Bihikut, Vehbi Balës, një shkrim i Rexhep Hoxhës lidhur me poezinë e Migjenit e të tjerë.

Një pjesë e këtyre shkrimeve janë nën ndikimin e teorisë të Timofejevit ose mbështeten kryesisht në teorinë e pasqyrit të estetit vulgar-marksist Todor Pavllovit. Gjithashtu, në shkrimet e ndonjërit prej tyre vërejmë edhe pikëpamjet e Lluqaçit, sepse krijimet e Migjenit merren vetëm si një mënyrë e njohjes së jetës. Pra, në pjesën më të madhe të këtyre shkrimeve kemi të bëjmë me aplikimin e një estetike negative, gnoseologjike, intelektualiste që mbetet në planin e parë, teknik, reprezentativ, mimetik, paraqitës, pasqyrues, shprehës e nuk hyn në imanencën e veprës, nuk përpiqet të zbulojë strukturën e saj, planin krijues, aspektin ontologjik e metafizik. Vepra e Migjenit ishte e denjë t'i bëhej, që në krye të herës, një kritikë shumështrësore, e cila filloi të zbatohet me sukses prej ndonjë autori, siç do të shohim, vetëm nga mesi i viteve '70. Ndërkaq, deri atëherë, të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me një tematizëm dhe ideologjizim të kritikës.

Meqë analiza tematike dhe kritika letrare ideologjike dalin nga tradita e pozitivizmit, mund të thuhet se në shkrimet që i kemi në shqyrtim, i hasim këto elemente: përshkrimin e materies pa kurrfarë ndriçimi teorik, rekonstruktimin përmes analizës sociale të rrethanave dhe të vrojtimit psikologjik të jetës së autorit, pastaj parafrazimin, përfoljen, inkorporimin e shprehjeve të poetit në ligjërimin kritik dhe princip e alegorezës, do të thotë shpjegimin final të kuptimit të një shkrimi etj. Ç'është e vërteta, në këto shkrime gjejmë edhe elemente të tjera, por këto që u cekën janë më karakteristike. Disa prej këtyre autorëve, duke analizuar temën, bëjnë një shpjegim alegorik të saj, pra zbatojnë metodën e alegorezës, e cila mëton të gjejë shpjegim definitiv, të japë kuptimin final, të mbyllur, pa i lënë udhë konotacionit, pluralitetit, mundësive të hapura dhe kreacionit, me të cilat është i mbrujtur dhe i konstituuar thujja secili krijim i Migjenit. Kështu, për shembull, vepron Koço Bihiku në analizën që i bën prozës së Migjenit, në një punim të dendur e mjaft të suksesshëm sa i përket precizitetit të komentimit dhe zbulimit të domethënies singulare të shkrimeve në prozë.

Në bazën e të gjitha këtyre shkrimeve qëndron postulati i njohur i cili bën që veprën e Migjenit ta vështrojmë si shprehje, refleks të rrethanave të kaluara ose të kushteve ekzistuese. Faktet letrare lidhen me ato jetësore, e disa momente apo përjetime të personazheve të ndonjë krijimi merren si qëndrime filozofike, morale, politike. Vërehet se e tërë analiza orientohet në konstituimin e botëkuptimit, të pikëpamjeve të shkrimtarit. Bëhet kështu një kalim, një kapërcim nga tema në ide dhe një kritikë shndërrohet në ideologji.

Megjithatë, në këto shkrime, siç u tha, hasim në elemente interesante, sepse në to ngriten çështje të rëndësishme dhe shqyrtohen probleme me vlerë të krijimtarisë së Migjenit.

Vështrimin e tij rreth poezisë së Migjenit<sup>13</sup> Rexhep Hoxha e fillon me analizën e gjendjes ekonomiko-politike dhe shoqërore, duke theksuar qëndrimin e Migjenit ndaj rrethanave të tilla. Pasi vë në pah karakteristikat e përgjithshme të poezisë, si tematikën, idetë dhe trajtimin e ri që u kundërviheshin tendencave klasiciste, romantizmit nacional dhe rrymave ekstreme moderne, autori analizon ndonjë aspekt të poezive të ndryshme. Kryesisht ai ndalet në motivet, por, krahas flet edhe për idetë, pikëpamjet, botëkuptimet dhe preokupimet e shkrimtarit, duke i ilustruar këto me fragmente të shkëputura nga krijimet e tij. Ai pra, nuk bën analizën e strukturës, por konstatimet e tij, vrojtimet dhe impresionet i ilustron me *pasuse* të ndryshme dhe në mënyrë panoramike i parafrazon disa poezi. Kjo mënyrë interpretimit me mjaft elemente impresioniste e shtyen shpesh autorin që të shfrytëzojë shprehjet e poetit dhe t'i futë, t'i inkorporojë në vështrimin e vet, ashtu siç vepron po në këtë kohë edhe Razi Brahimi, një hulumtues tjetër i veprës së Migjenit.

Një ndër çështjet e rëndësishme që i thekson Rexhep Hoxha në vështrimin e tij është universalizmi i temës tragjike që trajton Migjeni. Po vëmë në pah se këtë universalitet të temave dhe të subjekteve e spikat gjithashtu në mënyrë të pavarur edhe Razi Brahimi në vështrimin e tij mbi krijimtarinë e Migjenit.<sup>14</sup> Autori pastaj flet për formimin poetik, ndikimet e qarqeve letrare të letërsisë sociale në Jugosllavi, derisa Migjeni gjendej në Manastir. Ai presupozon mundësinë e bashkëpunimit të poetit tonë me njërin prej revistave jugoslave.<sup>15</sup> Sa i përket tematikës, këtu thuhet se Migjeni e zgjeroi atë duke futur temën sociale, „e ndryshoi krejtësisht përmbajtjen, formën dhe tonin e poezisë shqiptare që deri atëherë kufizonte lexuesin vetëm rreth një bote të ngushtë nacionale”.<sup>16</sup> Ky autor e hedh poshtë komparacionin që e kishte bërë dikur Arshi Pipa<sup>17</sup> midis Migjenit dhe Leopardit, duke i gjetur me të drejtë tjetërkund rrënjët e pesimizmit të të parit. Duhet të theksojmë çështjen e rëndësishme, të cilën e ngrit edhe Shuteriqi para këtij autori dhe shumë të tjerë pas tij, lidhur me ndikimin e Niçes. Rexhep Hoxha e pranon këtë ndikim, duke e arsyetuar për shkak të kushteve të cilat Migjenin e shtrëngonin të shprehej me simbole e aluzione. Sipas kësaj pikëpamje, Migjeni shfrytëzonte vetëm termi-

<sup>13</sup> Rexhep Hoxha, *Poezia e Migjenit*, „Jeta e re”, nr. 4, Prishtinë, 1958.

<sup>14</sup> Razi Brahimi, *Migjeni — flamur i letërsisë sonë luftarake*, Nëndori, nr. 8, Tiranë, 1958.

<sup>15</sup> Shih: Rexhep Hoxha, *Poezia shqipe*, „Jeta e re”, nr. 4, Prishtinë, 1958.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> Arshi Pipa, *Historia e dhimbëshme e Shpirtit të ri*, „Kritika” nr. 4, Tiranë, 1944.

nologjinë e Niçes, kurse botëkuptimi i tij ishte tjetërfare: mbinjeriu i Migjenit ndryshonte në esencë nga mbinjeriu i Niçes.

Një shkrim tjetër i rëndësishëm i kësaj etape, dhe, siç u pa, mjaft i ngjashëm me atë të Rexhep Hoxhës, sa u përket problemeve që trajton dhe mënyrës së shqyrtimit, është ai i Razi Brahimit.<sup>18</sup> Vetë titulli dhe një pjesë e madhe e këtij shkrimi flasin për epërsinë e vlerësimeve ideologjike mbi ato artistike. Gjuha dhe terminologjia me të cilat karakterizohet vepra dhe shkrimtari janë më tepër politike se sa kritiko-letrare, ato militojnë dhe kërkojnë anën ideore e nuk insistojnë në vlerat e vërteta artistike. Migjeni quhet poet i masave punonjëse e luftëtar i paepur për të drejtat e tyre. Në këtë shkrim, përveç tjerash, ka elemente të kritikës sociologjike me referenca të shpeshta për realitetin politiko-shoqëror të kohës. Mirëpo, në vështrimin e tij, Razi Brahimi, si kritik i talentuar, e lë shpesh dhijaren ideologjike dhe ngjitet shtigjeve artistike, duke i rrahur gjerësisht disa probleme me interes. Ai është ndër të parët që pas lufte e quan Migjenin realist kritik dhe i tregon shkallët e traditës që shpiejnë kah ai, duke përmendur me radhë si paraardhës Çajupin, Mjedën, Nolin, Asdrenin, R. Siliqen etj. Nga këta Migjeni trashëgoi edhe disa elemente romantike, kurse në disa shkrime, si në novelëzat apo në *Poemën e mjerimit*, mund të hasim edhe ndonjë moment impresionist. Megjithatë, sipas Razi Brahimit, në pjesën dërmuese të shkrimeve ai mbetet realist. Autori përpiket ta arsyetojë e ta mbrojë Migjenin për ato elemente jorealiste që gjenden në veprën e tij, duke theksuar se metoda artistike është kategori estetike dhe ajo nuk ka të bëjë me botëkuptimin e tij. Bëhet përpjekje që botëkuptimi revolucionar i Migjenit të mbetet i paprekur, pavarësisht pse ai nuk i përket një „metode revolucionare” siç është realizmi socialist dhe pavarësisht pse në shkrimet e tij mund të ketë veçori të stilit romantik. Asnjë metodë artistike nuk është ideologji. Kjo është e vërtetë, por ai disi gjendet midis dy zjarreve: në një anë do ta mbrojë artin e Migjenit, e në anën tjetër dëshiron ta ruajë edhe pozitën e tij ideologjike. Razi Brahimi gjithsesi do ta diferencojë Migjenin-njeri prej Migjenit-artist. Si njeri ai kishte pikëpamje të qëndrueshme ideologjike dhe politike, kurse si krijues paraqitet i liruar nga dogma, nga kallëpzimet dhe përcaktimet e ngushta metodologjike artistike. Sipas tij, Migjeni ishte një vullkan që nuk e ka bërë zap asnjë metodë, asnjë drejtim e, rrjedhimisht, asnjë ndikim i mundshëm. Kështu, autori mohon ndikimin e Gorkit, të Dostojevskit, të Hygoit e të Majakovskit. Disa elemente të ngjashme me veprat e këtyre shkrimtarëve që i hasim në shkrimet e Migjenit, janë marrë nga realiteti që e përjetonte vetë poeti. Pesimizmin dhe çështjen e mbinjeriut, Razi Brahimi i shpjegon më tepër si produkt të rrethanave dhe kushteve të kohës se sa si ndikim të literaturës. Sëmundjen dhe jetën e vështirë të poetit ai nuk i konsideron burim të elementeve dëshpruese e pesimiste që hasen në

<sup>18</sup> Razi Brahimi, *Migjeni — flamur i letërsisë sonë luftarake*, Nëndori, nr. 8, Tiranë, 1958.

disa krijime si *Rezignata*, *Vjeshta në parakalim*, *Vetëvrasja e trumcakut* etj. Pesimizmin e Migjenit, ky autor, është i prirur ta shohë si shprehje të revoltës dhe të protestës, sepse po të kuptohej si dëshpërim i thjeshtë, pavarësisht se me çfarë arti është trajtuar, do të rrënohej vlera artistike e, ç'është edhe më keq, do të degradohej në pikëpamje ideore, do të quhej dekadent e kushedi si ndryshe, nga mbikëqyrësit, manihejtë ideologjikë. Këtu qëndron arsyeja pse Razi Brahimi rrjepet duke e mbrojtur pa nevojë nga akuzat e mundshme shkrimatarin tonë. Ai dëshiron që ta nxjerrë krejt të pastër poetin në sytë e kujdestarëve shpirtërorë e ideorë. Edhe mbinjeriun e tij — i cili, siç do të shohim, do të jetë në qendër të diskutimeve kritike dhe nuk do të zbresë një kohë të gjatë nga rendi i ditës — përpiqet ta arsyetojë si alegori dhe simbol që nënkupton përpjekjen e ndryshimit të kushteve konkrete. Me një fjalë, Razi Brahimi, me mjaft shkathtësi kritike dhe me mendjemprehtësi e thotë të vërtetën për veprën e Migjenit, e zbulon strukturën e saj përmes analizës, por gjithnjë e vë në shërbim utilitar: vlerën e konstatuar artistike e mbulon përherë me vellon politike dhe pragmatike.

Pjesa më e madhe e kritikës deri vonë ka qenë e preokupuar në këtë aspekt ideologjik të veprës së Migjenit. Pikërisht për këtë, edhe problemet që janë trajtuar nuk kanë kontribuar në ndriçimin e strukturës së veprës dhe të kuptimit imanent të saj. Edhe kur është bërë ndonjë përpjekje drejt zërthimit të strukturës apo të kuptimit, siç është rasti me Mark Gurakuqin, Vehbi Balën apo Koço Bihikun, është përfolur thjesht përmbajtja, ka dominuar përshkrimi, prapë është vënë në spikamë së tepërmi tema dhe ideja, janë përsëritur shpjegimet, komentimet dhe interpretimet e mëparshme, është theksuar një kuptim i prerë e i vetëm i një krijimi. Si rrjedhim i gjithë kësaj janë ngritur çështje që nuk janë me rëndësi për vlerën strukturale e artistike të veprës, siç është ajo se a ka te Migjeni elemente të realizmit socialist, pastaj hudhja e disa krijimeve pse përmbajnë tone pesimiste dhe pse trajtohet ideja e mbinjeriut. Pra, edhe kur vepra është shqyrtuar në mënyrë të gjerë e të kompletuar siç është monografia, ajo është kurorëzuar, prapë-seprapë, me kriterin ideor e ideologjik.

Megjithatë, do të ishim të njëanshëm po të mos e pranonim faktin se këta autorë kanë ndriçuar disa probleme dhe kanë syzuar disa elemente interesante në veprën e Migjenit, madje edhe atëherë kur pikëpamjet, botëkuptimet e autorit i kanë vënë në plan të parë. Kështu, në shkrimin „Tema antifetare në veprën e Migjenit”,<sup>19</sup> Mark Gurakuqi duke bërë një analizë aspektit ideologjik antifetar lidhet me çështje më të thella morale dhe filozofike. Ai thotë se Migjeni përmes demaskimit të fesë e zvesh moralin e rrejshëm kristian, kurse thelbi i këtij demaskimi është zhdukja e zotit. Ky mendim vetvetiu na kujton pikëpamjen e Niçes për zotin e vdekur.

<sup>19</sup> Mark Gurakuqi, *Tema antifetare në veprën e Migjenit*, Nëndori nr. 8, Tiranë, 1967.

Gjithashtu, edhe në studimin monografik të Vehbi Balës<sup>20</sup> për jetën dhe veprën e Migjenit si dhe në atë të Koço Bihikut<sup>21</sup> rreth prozës së tij, hasim në vrojtme të qëlluara të aspektit semantik nganjëherë edhe struktural. Për skicat e Migjenit, Vehbi Bala thotë se kanë harmoninë e brendshme të prozës poetike dhe konstaton monologun e brendshëm. Mirëpo, është interesant se ky autor shpeshherë e fillon mirë analizën filozofike (për prozën *Sokrat i vujtun...* dhe *Vetvrasjen e trumcakut*) por pastaj e ndërpret duke kaluar menjëherë te skicat me brendi shoqërore, siç është rasti me prozën *Luli i vocër*, por edhe këto i ritregon dhe i parafrazon përmes shprehjeve të poetit. Marrë në tërësi, as prozës as poezisë në këtë studim nuk u bëhet një analizë artistike, imanente, estetike, por si në pjesën më të madhe të historishkrimit tonë letrar rreth veprës së Migjenit, edhe këtu trajtohet aspekti ideo-tematik. Për disa poezi theksohet vetëm motivi, tema, preokupimi, brendia; flitet për angazhimin aktual të artit të Migjenit, qortohet pesimizmi, intimiteti i disa krijimeve dhe mendimet filozofike. Ndërkaq, *Poemën e mjerimit*, autori, e quan ligjëratë e një agjitorit duke i dhënë analizës së saj plotësisht karakter sociologjizues. Pas të dhënave biografike, pas shkoqitjes së temave e motiveve dhe shqyrtimit të krijimtarisë kryesisht në aspektin ideo-tematik, ky autor jep një vështrim të përgjithshëm panoramik, normativ për të gjitha tiparet dhe veçoritë e krijimeve në prozë dhe në poezi.

Sa i përket prozës, studimi i Koço Bihikut është ndër më të kompletuarit deri më tash. Sado që autori përqëndrohet kryesisht në brendinë e krijimeve në prozë pa u ndalur në shqyrtimin e stilit e të formësimit, interpretimet dhe shpjegimet e tij depërtojnë në thelbin e kuptimit të tekstit, e gjejnë domehënien kryesore, dominantën e tij dhe lëshohen në referenca interesante me kontekstin kohor aktual e historik. Qëllimi i kësaj analize të strukturës semantike është që ta shtrojë sa më shumë kuptimin dhe ta finalizojë domethënien. Kjo tendencë e shtyen autorin në polemikë me pikëpamjet, mendimet dhe shpjegimet e të tjerëve rreth ndonjë problemi. Në këtë drejtim, autori bën vrojtme të thella dhe e shqyrton materien në tërësinë e saj, duke syzuar momente mjaft të rëndësishme kuptimore, ndonjëherë filozofike, e veçmas ideore në strukturën e skicave dhe të llojeve të tjera të prozës. Poenta e kësaj kritike ideo-tematike është e orientuar kah theksimi i vlerës ideore. Autori, pra, askund nuk e cek si janë realizuar këto krijime, nuk e tregon mënyrën e rrëfimit, strukturën narrative, por të gjitha observimet dhe vlerësimet e tij çojnë në hullinë e ideshmërisë. Ç'është e vërteta, këtij lloji të kritikës i intereson vetëm ky aspekt dhe kur është në pyetje ana ideore, aspektet e tjera ose abstrakohen ose analizat dhe gjykimet rreth tyre duhet të jenë në shërbim të

<sup>20</sup> Vehbi Bala, *Migjeni, portret — monografi*, „Naim Frashëri”, Tiranë, 1974.

<sup>21</sup> *Studime filologjike*, nr. 4, Tiranë, 1971.

saj. Për fat të mirë në këtë studim të Koço Bihikut jo gjithherë ndodh kështu, sepse analiza shpesh mbetet në planin objektiv tekstual pa iu referuar çështjeve aktuale ideologjike.

*Sefedin Fetiu*

#### L'OEUVRE DE MIGJENI DANS LA CRITIQUE D'APRES GUERRE

##### Résumé

Après la Libération l'oeuvre de Migjeni était au centre des observateurs critiques en raison de l'intérêt et de l'attention suscités par les thèmes traités et de leur valeur artistique.

Dans les premières critiques d'après guerre l'accent était davantage mis sur l'aspect utilitaire, pratique des idées et des thèmes, plus tard, la critique contemporaine examinera aussi la valeur structurale et artistique de l'oeuvre de Migjeni. Dans notre étude nous avons relevé trois tendances qui se dégagent de la critique d'après guerre au sujet de l'oeuvre de Migjeni: tendance esthétique, utilitaire et idéo-artistique. Chacune de ces tendances a naturellement ses représentants. Nous nous sommes efforcé d'examiner séparément les écrits de ces écrivains: Dhimiter Shuteriqi, Razi Brahimi, Rexhep Hoxha, Mark Gurakuqi, Vehbi Bala, Koço Bihiku, Petro Janura ect. Nous avons fait une observation critique partielle des écrits de Migjeni concernant les idées, et les thèmes, nous n'avons pas abordé la critique d'après guerre au quelques critiques contemporains manifestent une tendance et une approche structurale et esthétique.